

KONKURS

ÇMIMI “PROFESOR EKREM BEQIRI”

Për esenë më të mirë nga studentët

Çmimi “**Profesor Ekrem Beqiri**” është themeluar në vitin 2010 nga Bordi i Institutit Riinvest për të përjetësuar emrin dhe veprën e Profesor Ekrem Beqirit dhe nderuar kontributin e tij të madh në shkencën kosovare, veçanërisht në zhvillimin dhe avancimin e kërkimeve shkencore në Kosovë dhe në vetë Institutin Riinvest. Ky çmim synon të nxisë iniciativën, kreativitetin dhe aftësitë kërkimore të studentëve në fushën e shkencave ekonomike dhe sociale.

Këtë vit, Çmimi “**Profesor Ekrem Beqiri**” do të ndahet në kuadër të aktiviteteve që shënojnë 30-vjetorin e Institutit Riinvest.

Bordi i Institutit Riinvest inkurajon të gjithë studentët të aplikojnë me esetë e tyre. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët kosovarë, brenda dhe jashtë vendit.

Formati i eseut:

- Fonti: Times New Roman, 12 pt
- Hapësira midis rreshtave: 1.5
- Gjatësia e tekstit: 900-1000 fjalë, përfshirë shënimet në fund të faqes
- Margjinat e faqes: 2.54 cm nga të gjitha anët
- ♦ **Shënim:** Eseja që nuk i përmbahet formatit të kërkuar do të diskualifikohet nga gara.

Shpërblimi dhe përzgjedhja e fituesve:

Një komision profesional i përbërë nga tre (3) anëtarë do të vendosë për përzgjedhjen e fituesve. Fondi i çmimit është 600 euro, i cili mund të ndahet për një (1) deri në tre (3) esetë më të mira.

Mënyra e aplikimit:

- Eseja duhet të dërgohet me email në adresën: riinvest@riinvestinstitute.org
- Subjekti i emailit: *Konkursi për Çmimin “Profesor Ekrem Beqiri”*
- Për më shumë informata mund të na kontaktoni në numrat: +383 38 244 320 | +383 44 208 235
- Afati për aplikim mbetet i hapur nga data 14 Mars deri me 10 Prill 2025